

AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Er Li Pets SHPK”

Sot me date 29/05/2024 (Njëzet e nëntë maj dymijë e njëzet e katër), u mbledhën themeluesit në adresën Rruga 3 Nr 46/6, ndertesa nr 8, kati 1, Paskuqan Kamëz Tiranë, Shqipëri të cilët bazuar në legjislacionin në fuqi, në nenet 68 e vijues të ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, Ligjit nr. 9723, dt.03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, Ligj Nr. 131/2015 Për Qëndren Kombëtare të Biznesit” në dispozitat e Kodit Civil si dhe në vullnetin e tyre të lirë kanë rënë dakord për themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas rregullimeve në vijim:

KREU I.

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJE, SELIA

NENI 1

Emri

Emri i shoqërisë është “Er-Li Pets” Sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 2

Ortakët themelues

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. Znj. Eriona Dobrovoda, shtetase Shqipëtare, atësia Vehbi, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 29/05/1984, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me ID nr.I45529044W.

të cilët themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “Er-Li Pets” Sh.p.k. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin në fuqi në territorin e Shqipërisë dhe dispozitat e Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti.

NENI 3

Objekti i Shoqërisë

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Import, eksport dhe tregtim i ushqimeve të thata, ushqimeve të konservuara, ëmbëlsirave, shamos dhe produkteve të kujdesit për lëkurën, veshjeve, lodrave, pelenave etj, për kafshët shtëpiake dhe kafshë prodhimi.
- Tregtia me shumicë e pakicë e kafshëve të gjalla.
- Dyqan kafshësh shtëpiake.
- Tregtimi me pakicë i barnave për kafshë.
- Importi, eksporti dhe tregtimi i vitaminave dhe suplementeve për kafshët shtëpiake dhe kafshë prodhimi.
- Larja, pastrami dhe trajtimi (larje, qethje etj.) për kafshët shtëpiake (grooming).
- Kurse trajnimi për larjen dhe pastrimin e kafshëve shtëpiake (grooming).
- Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.
- Tregtimin nëpërmjet internetit, quajtur ndryshe dhe si "e-commerce" dhe dhënien e shërbimeve të lidhura me të.
- Dhënie ambjentesh me nënqera.
- Organizim dhe zhvillim i eventeve, trajnimeve dhe kurseve të formimit profesional.

Shoqëria, me vendim të organit administrativ, dhe me qëllim arritjen e objektit të saj, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që organi administrativ do ta konsiderojë të nevojshëm. Për këtë qëllim, Shoqëria mund të lidhë marrëveshje apo kontrata qiraje, shit-blerje a hipotekimi të pasurive të paluajtshme, kontrata kredie, shërbimi dhe marrëveshje a kontrata të tjera të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

NENI 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohë të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar.

NENI 5

Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga 3 Nr 46/6, ndertesa nr 8, kati 1, Paskuqan Kamëz Tiranë, Shqipëri. Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose të krijojë filiale, si dhe të kryejë aktivitetin e saj si brënda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

KREU II

KAPITALI

NENI 6

Kapitali i Regjistruar

Kapitali themeltar është 100,000 (Njëqind Mijë) Lek dhe është i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale, 1 kuotë 100,000 (Njëqind Mijë) Lek. Kapitali themeltar është nënshkruar dhe derdhur tërësisht nga Ortakët Shoqërisë si mëposhtë:

1. Znj. Eriona Dobrovoda, shtetase Shqipëtare, atësia Vehbi, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 29/05/1984, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me ID nr.I45529044W zotëron 1 kuotë që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë, me vlerën nominale 100,000 lekë, e shlyer tërësisht.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme, apo të drejta)

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit të regjistruar për kontribute në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohet për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen si mëposhtë :

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Cdo mënyre tjetër e parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organet Vendimmarrëse

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet si më poshtë:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) Ndryshimin e statutit
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorit/administratorëve
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën c) e d)
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) Miratimin e bilanceve
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Përfaqësimin në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/administratorëve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l) Miraton rregulla proceduriale të mbledhjeve të asamblesë
- m) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është e thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë personalisht apo votojnë me shkresë apo elektronikisht ortakët, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumica të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse kuorumi i përmendur në paragrafin e mësipërm nuk arrihet, asambleja e përgjithshme, mbidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e Vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesmarrës, për çështje të tjera.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në regjistrin e shoqërisë.

Neni 13

Përfundimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendimin për:

- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij
- c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria
- d) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 14

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit/administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Në respekt të **limiteve dhe kufizimeve të parashikuara në Aneksin 1 të këtij Statuti** Shoqëria do të drejtohet dhe përfaqësohet nga dy administratorë, që janë:

Z. Fabian Islamlari, shtetas Shqipëtar, atësia Gramoz, lindur në Çorovodë, Shqipëri, më 28/05/1997, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me ID nr. J70528003L.

Znj. Eriona Dobrovoda shtetase Shqipëtare, atësia Vehbi, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 29/05/1984, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me ID nr. I45529044W.

Administratorët mund të shkarkohen në çdo moment me vendim të Ortakëve.

Gjithashtu, Administratorët mund të shkarkohen në çdo moment me vendim të Autoritetit Gjyqësor kompetent për shkelje të ligjit.

Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratorët të cilët kryejnë të gjitha veprimet në lidhje me aktivitetin e zakonshëm apo të jashtëzakonshëm të Shoqërisë veç e veç ose së bashku sipas limiteve dhe kufizimeve të përcaktuara në **Aneksin 1**.

Neni 15

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- a) Menaxhojnë aktivitetin e biznesit të Shoqërisë duke zbatuar politikat dhe planifikimet e përcaktuara nga Ortaku i Vetëm;
- b) Përfaqëson Shoqërinë (sipas kufizimeve të përcaktuara në Aneksin I);
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurisë së veprimtarisë si dhe raporte të tjera sipas kërkesave ligjore dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimit, i paraqesin këto dokumenta përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim
- e) Krijojnë një sistem paralajmerimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhëna të detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombetare të Regjistrimit.
- g) Raportojnë para Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet relacioneve mbi zbatimin e politikave të shoqërisë dhe të veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë
- h) Kryejnë detyra të parashikuara nga ligji dhe statuti

Administratorët janë individualisht përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkelje të ligjit dhe/ose Statutit.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit/Administratorëve

1. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Administratorët të cilët kanë kryer veprime ose bërë marrëveshje të pa aprovuara nga asambleja, janë përgjegjës për dëmet e sjella shoqërisë dhe përgjigjen personalisht ose solidarisht për pasojat.
2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale është i detyruar të dëmshpërmbledjë shoqërinë për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

KREU IV
VITI FINANCIAR- EKSPERTET

Neni 17

Viti Financiar

Viti financiar fillon me date 1 Janar dhe mbyllet me datë 31 Dhjetor të çdo viti. Përbashimisht, viti i parë financiar do të fillojë nga dita e regjistrimit pranë Regjistrimit Tregtar dhe do të përfundojë më 31 Dhjetor 2024.

Neni 18

Ekspertët Kontabël

Asambleja e Ortakëve do të emëroje një apo më shumë Ekspertë Kontabël në ato raste kur emërimi behet i nevojshëm në bazë të ligjit.

KREU V

PRISHJA- RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 19

Prishja/ Likuidimi

Shoqëria konsiderohet e shpërndarë kur:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar e shoqërisë
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) Me vendim gjykate

Në rast prishje a likuidimi të shoqërisë, normat për likuidimin dhe emërimin e likuiduesve do të vendosen nga Ortakët e shoqërisë në bazë të ligjit në fuqi në territorin e Shqipërisë.

Neni 20

Riorganizimi i Shoqërisë

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit mbi shoqëritë tregtare.

Neni 21

Klauzola mbi konfliktin e interesit

Ortakët dhe administratori/administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë pozicionin drejtues apo të jenë të punësuar në një shoqëri që ushtron aktivitet në të njëjtën fushë me të parën.

Ndalimi i pikës 1 mund të anulohet në Asambleshë e parë të përgjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave, sipas dispozitave të neneve 87 dhe 145 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Neni 22

Legjislacioni

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

KREU VI

TE TJERA

Neni 23

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, si dhe ato që mund të lindin midis ortakëve ose midis një apo disa ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtëpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 24

Gjuha

Ky statut është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKET THEMELUES

ERIONA DOBROVODA

ERIONA DOBROVODA

ANEKSI 1

KUFIZIMET E KOMPETENCAVE, PERJASHTIMET DHE LIMITIMET PER ADMINISTRATORET DHE PERFAQESUESIT E AUTORIZUAR

1. Kompetencat menaxhuese dhe detyrat e Administratorëve

Z. Fabian Islamlari, në cilësinë e administratorit, do të ketë kompetencat, detyrat e mëposhtme gjatë ushtrimit të detyrës së tij:

1. Të përfaqësojë ligjërisht Shoqërinë dhe të nënshkruajë në emër dhe për llogari të Shoqërisë të gjitha aktet, aktivitetet e biznesit dhe kontratat në të cilat Shoqëria ka një interes apo është palë në to, subjekt i kufizimeve të përcaktuara në pikën d) më poshtë.,
2. Të menaxhojë dhe administrojë të gjithë veprimtaritë dhe astetet Shoqërisë, duke përfshirë veprimtaritë e biznesit të një natyre tregtare dhe industriale, dhe të ndërhyjë në çdo veprimtari biznesi të lidhur me Shoqërinë, duke siguruar përfaqësimin e Shoqërisë përpara administratës publike autoriteteve të saj, entiteteve dhe zyra të çfarëdolloj hierarkie, dhe të përfaqësojë Shoqërinë përpara çdo Shoqërie ndërmarrje ose individit për ushtrimin e të gjitha veprimeve juridike ose jo juridike, brenda Republikës së Shqipërisë si dhe të ekzekutojë vendimet e miratuara nga Administratorët,
3. Të informojë rregullisht Administratorët për situatën e biznesit, situatën e Shoqërisë dhe rethanat veçanërisht të rëndësishme në lidhje me ushtrimin e biznesit të Shoqërisë
4. Të përgatisë dhe ti paraqesë Administratorëve, në fillim të çdo viti fiskal buxhetin e Shoqërisë për vitin përkatës si edhe planin e marketingut, me qëllim miratimin e tyre nga ana e Administratorëve.
5. Të menaxhojë veprimtaritë e Shoqërisë në emër të Shoqërisë në përputhje me udhëzimet e dhëna nga administratorët duke zbatuar vendimet e miratuara nga Administratorët, dhe të ndërmarrë të gjitha masat të cilat janë të nevojshme për ushtrimin e biznesit dhe të ndërhyjë në çdo veprimtari biznesi që është e lidhur me Shoqërinë.
6. Të nënshkruajë dhe të kontrollojë korrespondencën, si edhe të nënshkruajë të gjitha llojet e faturave të pagueshme dhe të gjitha faturat e tjera të cilat kërkohen për menaxhimin e Shoqërisë
7. Të dërgojë të gjitha llojet e njoftimeve dhe të marrë në dorëzim çdo njoftim, si dhe t'ju kthejë përgjigje të gjithë njoftimeve që i adresohen Shoqërisë.
8. Të kërkojë çfarëdolloj informacioni, përfshirë por pa u kufizuar lidhur me çdo lloj çertifikate përpara Regjistrimit Tregtar, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe përpara çdo Regjistrimi tjetër publik apo Zyra qeveritare.
9. Të hap, përdorë, dhe të mbyllë llogari bankare në emër të Shoqërisë brenda Republikës së Shqipërisë, dhe të operojë këto llogari bankare në përputhje me kompetencat e tij për veprimet bankare të miratuara nga Administratorët, kohë pas kohe, duke përfshirë por pa u kufizuar në tërheqjen e fondeve nënshkrimin e çqeve, urdhërpagesave dhe dokumentave të tjera, si edhe të miratojë bilancet dhe likuidimet ose, kur është e përshtatshme, të kundërshtojë të njëjtën gjë dhe të veprojë për korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të pikës 3. **Kompetencat Bankare**
10. Në varësi të shumës limit të përcaktuar në pikën d) dhe e) më poshtë, të nënshkruajë në emër të shoqërisë çdo lloj kontrate ose marrëveshje.
11. Në varësi të kufizimeve të përcaktuara në pikën c) më poshtë, të punësojë, menaxhojë transferojë dhe shkarkojë personelin e shoqërisë, agjentët, përfaqësuesit e tjerë dhe të ushtrojë të gjitha kompetencat e tjera të menaxhimit të personelit me kompetencën për të ndryshuar kategorinë e

punësimin, me ose pa dëmshpërblim: të përcaktojë kompetencat e tyre, autoritetin, të drejtat dhe detyrimet si dhe, shpërblimin e tyre proporcional apo përfundimtar të caktuar, të jap bonuse dhe shpërblime të jashtëzakonshme si të merituar dhe të autorizojë ndihma dhe subvencione të konsideruara të përshtatshme për të mirën e personelit në fjalë.

12. Të blejë, duke përfshirë nën qira financiare, të shesë ose jap me qira të gjitha llojet e makinerive, lëndëve të para, mallrave dhe furnizimet e nevojshme, duke nënshkruar për qëllime të tilla urdhërat, faturat, dokumentet publike dhe private në lidhje me ato transaksione, duke përcaktuar në të termat dhe kushtet në lidhje me çmimin, mënyrën e pagesës dhe të dispozitave të tjera të nevojshme ose të përshtatshme për interes të Shoqërisë
13. Të kontrakttojë furnizime të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të Shoqërisë, duke përfshirë, ndër të tjera, të gjitha llojet e fushatave të marketingut dhe promovime si dhe aktivitetet e marketimit.
14. Të vendosë për çdo çështje tjetër me interes për Shoqërinë brënda kontekstit të qëllimit të ekzistencës së saj, edhe pse nuk përmendet shprehimisht në këto kompetenca, me qëllim që të mos lindin vështirësi për shkak të mungesës së shprehjes së autorizimit në këtë Statut.

Znj. Eriona Dobrovoda, në cilësinë e administratorit, do të ketë kompetencat, detyrat e mëposhtme gjatë ushtrimit të detyrës së tij:

15. Ka të drejtë të nënshkruaj dhe të aplikoj online në portalin e-albania dhe /ose pranë zyrave të QKB, çdo shkresë, kërkesë për regjistrim dhe/ose çrregjistrim biznesi , si dhe çdo veprim ndryshimi apo ndryshimesh të mundshme në Shoqëri.
16. Ka të drejtë të nënshkruaj dhe të aplikoj online në portalin e-albania dhe /ose të përfaqësojë Shoqërinë pranë zyrave të QKB për çdo veprim të nevojshëm dhe që ka lidhje me pezullimin, kalimin në statusin aktiv dhe / ose mbylljen e aktivitetit të Shoqërisë.
17. Ka të drejtën të aplikoj online në Portalin E-albania dhe të nënshkruajë elektronikisht çdo kërkesë dhe të kryej çdo procedurë apo veprim tjetër të nevojshëm për Shoqërinë.
18. Të përfaqësojë shoqërinë pranë çdo institucioni qëndror apo lokal, shtetëror apo privat, si Bashki, Prefekturë, Komunë, Drejtoria e Tatim Taksave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, apo çdo institucion tjetër shtetëror ose privat që do të jetë i nevojshëm në ecurinë e Shoqërisë, të depozitojë shkresa, kërkesa, të kërkoj informacion, etj pranë këtyre institucioneve.
19. Të përgatisë propozimin për llogaritë dhe bilancin, dhe shënimet në lidhje me to, së bashku me propozimin për shpërndarjen e fitimit, në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe brënda përkufizimeve ligjore të statullit, dhe ta paraqesë tek Administratorët për parashtrimin më pas në Asamblenë e Ortakëve.
20. Të nënshkruajë dhe depozitojë në emer të Shoqërisë të gjitha deklaratat e nevojshme tatimore në lidhje me taksat kombetare, rajonale ose komunale, si dhe vleresimit perkatese likuidimet ;te nënshkruajë dhe dorëzojë në emer të Shoqërisë çdo lloj formulari, informim apo njoftimit ndaj autoritetit monetar kompetent.
21. Të hap, përdorë, dhe të mbyllë llogari bankare në emër të Shoqërisë brenda Republikës së Shqipërisë, dhe të operojë këto llogari bankare në përputhje me kompetencat e tij për veprimet bankare të miratuara nga Administratorët, kohë pas kohe, duke përfshirë por pa u kufizuar në tërheqjen e fondeve nënshkrimin e çeqeve, urdhërpagesave dhe dokumentave të tjera, si edhe të miratojë bilancet dhe likuidimet ose, kur është e përshtatshme, të kundërshtojë të njëjtën gjë dhe të veprojë për korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të pikës 3. **Kompetencat Bankare**

2. KUFIZIMET E KOMPETENCAVE, PERJJASHTIME DHE LIMITIME

Çdo transaksion tjetër, duke përfshirë por jo i kufizuar në ato të listuara më poshtë, në çdo rast kërkon miratimin paraprak unanim me shkrim të Administratorëve të Shoqërisë

- a. Blerja, shitja dhe barra e pronës së patundshme në Republikën e Shqipërisë;
- b. Hapja e degëve të reja dhe mbyllja e degëve ekzistuese, zyra, si dhe marrja me qira ose nënqira e ndërtesave ose ambienteve për zyra dhe facilitete të Shoqërisë;
- c. Lidhja e kontratave të punës për punësimin e stafit të shoqërisë me një pagë bruto më të madhe se € 10,000/person në vit
- d. Ekzekutimi i çdo lloj kontrate tregtare apo komerciale apo akti tregtar të çdo lloji që sjellin një detyrim pagese për Shoqërinë prej më shumë se € 10,000 si detyrim total i kontratës (për vitin e kontratës që ka angazhimin më të lartë);
- e. Ekzekutimi i marrëveshjeve parapaguese që i sjellin një detyrim pagese Shoqërisë për të paguar më shumë se € 10,000 si angazhim total vjetor (për vitin e kontratës që ka angazhimin më të lartë);
- f. Dhënie e përfitimeve të palëve të treta dhe/ose hyrja në marrëveshje jashtë rrjedhës normale të biznesit;
- g. Lidhja e marrëveshjeve të kredisë (si huamarrës ose huadhënës);
- h. Ofrimin e garancive, si dhe për detyrimet e palës së tretë;
- i. Blerja e aksioneve ose pjesëmarrja në çdo lloj Shoqërie tregtare dhe civile; dhe
- j. çdo akt tjetër rezervuar posaçërisht për Asamblenë ose për Administratorët.

3. KOMPETENCAT BANKARE

Administratorët do të kenë kompetenca për të vepruar në të gjitha llogaritë bankare të Shoqërisë në Republikën e Shqipërisë sipas skemës në vijim:

Për llogaritë në euro, usd dhe në lekë:

Niveli 1 - Fabian Islamllari do të jetë person i autorizuar për të vepruar në llogaritë bankare të Shoqërisë deri në një shumë maksimale prej 5,000 € dhe ekuivalenti i tij në monedhën usd dhe lekë për transaksion.

Niveli 2 - Fabian Islamllari së bashku me Eriona Dobrovoda të jenë persona të autorizuar për të vepruar në llogaritë bankare të Shoqërisë për veprime mbi 5 001 € dhe ekuivalenti i tij në monedhën usd dhe lekë për transaksion.